Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0383

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE Ideal Shala B.I., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim Me Pjesë Për Automjetet Toyota Land Cruser 150" me numër të prokurimit 214-23-1737-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, më 03/08/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e Ideal Shala B.I. me nr. 2023/0383, e datës 12/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim Me Pjesë Për Automjetet Toyota Land Cruser 150" me numër të prokurimit 214-23-1737-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: Ideal Shala B.I., refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës sipas nenit 31.5 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 07.03.2023 ka paraqitur Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim Me Pjesë Për Automjetet Toyota Land Cruser 150" me numër të prokurimit 214-23-1737-1-1-1.

Me datë 23.05.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datën 29.05.2023 OE Ideal Shala B.I .ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Policia e Kosovës. Ndërsa me datën 01.06.2023 AK - Policia e Kosovës, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 12.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 383/23.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 170,000.00€.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtroj ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datë 29.06.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- të refuzohet si e pabazuar ankesa e OE ankues,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK..

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik nuk ka dhënë mendim rreth raportit të ekspertit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere prej minimum 200,000.00€",*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar*: "Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum 200,000.00€;*

Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë".

Lidhur me referencën e Ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë e cila është lëshuar nga "EULEX", eksperti shqyrtues sqaron se në këtë referencë theksohet që "EULEX" bashkëpunon me kompaninë Autotrade që nga 2008, mirëpo të dhëna të tjera si data e lëshimit të referencës, shuma e kontratës dhe lloji i kontratës nuk janë theksuar, gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 3 kontrata me "Eulex" të cilat janë një vjeçare. Kontrata e ofruar është me dt. 14.06.2019 dhe mbanë shumën 250 000.00 Euro, kontrata tjetër është e lidhur me dt. 25.06.2020 dhe mbanë shumën 280 000.00 Euro dhe kontrata tjetër e lidhur me dt.01.06.2022 dhe mban shumën 280 000.00 Euro.

AK-ja i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë ku përgjigjja e tyre ka qen se: "*...ndërsa në referencë nuk e ka cek shumën pasi që është kundër rregullave interne të privatësisë*". Eksperti shqyrtues, thekson se pavarësisht arsyetimit të OE të rekomanduar për kontratë, AK konform Nenit 72.3 të LPP-së është dashur të kërkoj nga "Eulex", sqarime, nëse të njëjtit kanë përfunduar kontratë të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe të verifikoj se sa është shuma e kontratës. Andaj pretendimi i OE ankues për referencën e Eulex është pjesërisht e bazuar.

Përgjigje për referencën "United Nations"

Ne lidhje me referencën e United Nations është e lëshuar pas njoftimit për kontratë, dhe kjo kontratë ka të shënuar një numër të kontratës i cili nuk ju përket kontratave të cilat janë bashkangjitur,

Lidhur me referencën e Ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë e cila është lëshuar nga "UNITED NATIONS", eksperti shqyrtues sqaron se kjo referencë është lëshuar me dt.22.03.2023, por kjo datë mund të pranohet për shkak se është para hapjes së ofertave, mirëpo në referencë figuron që kontrata është nga periudha 2010 deri me tani. Gjithashtu numri i kontratës i paraqitur në referencë nuk është i njëjtë me numrin të paraqitura në kontrata.

Gjithashtu nga "UNMIK" është paraqitur kontrata me OE "Auto trade sh.p.k", e cila është në periudhë kohore nga 14 Tetor 2018 deri 13 Tetor 2019.

kontrata tjetër është me periudhë kohore nga 14 Tetori 2019 deri 13 Tetor 2020, dhe

kontrata tjetër është 14 Tetor 2020 deri 13 Tetor 2021.

Eksperti Shqyrtues, thekson se Referenca e lëshuar nga United Nations nuk e ka të specifikuar shumën e cila është kërkesë e dosjes së tenderit. Gjithashtu kontratat e "UNMIK" jo të gjitha janë të pranueshme për faktin se disa janë të përfunduara më shumë se sa tre vite nga njoftimi për kontratë.

Andaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK është dashur konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti kërkojë sqarime institucionit i cili e ka lëshuar referencën dhe të vërtetoj shumën e realizimit të kontratave në periudhë tre vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, me që ky institucion ka nënshkruar kontratat të cilat janë të bashkangjitura në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje për referencën "Vitaminka"

Referenca Vitaminka për të cilën OE ankues thekson se data e referencës është pas datës së njoftimit për kontratë, dhe kjo kontratë ka vetëm shërbime dhe nuk ka furnizime, eksperti shqyrtues thekson se kjo referencë edhe pse e ka datën pas njoftimit për kontratë është para hapjes së ofertave dhe kjo është e pranueshme për shkak se mund të verifikohet ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 72.3 e LPP-së, ndërsa sa i përket se kjo referencë nuk ka furnizime, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit është kontrata të njëjta ose të ngjashme, andaj meqë AK ka përdorur lidhëzën OSE atëherë janë të pranueshme edhe shërbime të ngjashme. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigjje për referencën "Avis Budget" Referenca "Avis Budget" ku OE ankues thekson se kjo referencë është pas datës së njoftimit për kontratë, ku sipas kërkesës së AK-së është e pa vlefshme, kjo kontratë nuk ka furnizime por mirëmbajtje, eksperti shqyrtues sqaron se referenca është lëshuar më dt. 07.04.2023 e cila është pas njoftimit për kontratë mirëpo referenca është para hapjes së ofertave dhe mund të verifikohet në mënyrë Objektive sipas nenit 72.3 të LPP-së, ndërsa në lidhje me natyrën e kontratës, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit thekson se kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme, andaj për vetë faktin se AK ka lejuar edhe kontrata të ngjashme mund të konsiderohet e pranueshme referenca. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigje për referencën “Hej Taxi Sh.p.k”

Referenca “Hej Taxi Sh.p.k”, OE ankues thekson se është pas njoftimit për kontratë dhe kjo kontratë nuk ka furnizime por vetëm shërbime. Eksperti Shqyrtues, sqaron se kjo referencë është lëshuar me dt. 07.04.2023 e cila është pas datës së njoftimit për kontratë, mirëpo është para hapjes së ofertave dhe kjo mund të verifikohet konform nenit 72.3 të LPP-së. Ndërsa në lidhje me natyrën e kontratës, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit thekson se kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme, andaj për vetë faktin se AK ka lejuar edhe kontrata të ngjashme, gjithashtu në sqarimet e kërkuara nga AK për OE i rekomanduar për kontratë i njëjti i përgjigjet si në vijim:”... *po ashtu me kontratën që kemi bëhet furnizimi i pjesëve sipas nevojës dhe jo vetëm servisimi i rregullt por furnizim si dhe riparime tjera*”. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Ndërsa sa i përket listës së çmimeve kategoria A, AK-ja ka nda 50% peshim që do të thotë se këto pjesë do të implementohen 50% e kësaj kontrate, ku OE i rekomanduar ka ofruar çmim shumë të larta në krahasim me çmimin e ofertës tonë.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se AK ka respektuar dispozitën e nenit 61 të LPP-së, dhe i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë ku i njëjti me dt. 11.05.2023 i përgjigjej AK-së, ku i ka arsyetuar çmimet, Andaj eksperti shqyrtues, vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar për faktin se AK është bindur me përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pa bazuar dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Operatori ekonomik ankues në këtë rast, në asnjërin pretendim të tij ankimor të vendosur në ankesën e tij, nuk e mbron eliminimin e tij nga ky aktivitet i prokurimit, por me pretendime të tij e atakon vetëm OE të rekomanduar, i cili edhe e ka ofertën më të lirë. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: "*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*."

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas shumës së ofruar është i radhitur i 2 (dyti) me radhë në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e eleminuar dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij e atakon vetëm të rekomanduarin e nuk e argumenton se oferta e tij është e përgjegjshëme.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 te këtij ligji". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar ne këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Lidhur me këtë OSHP përmes njoftimit të publikuar në ueb faqen e saj të internetit i ka njoftuar të gjitha palët si si mund ta fitojnë statusin e palës me interes. Pikërisht në këtë njoftim theksohet se OSHP ka të drejtë ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe është i obliguar ta konfiskoj tarifën ankimore nëse, pika a, citohet: "Nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eleminimin e tij/sajë dhe/ose nuk e argumenton faktin/pohimin bazë se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë."

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP. Ndërsa, autoriteti kontraktues mbanë përgjegjësi të plotë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore për prokurimit publik. Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Operatori ekonomik ankues në këtë rast, në asnjërin pretendim të tij ankimor të vendosur në ankesën e tij, nuk e mbron eliminimin e tij nga ky aktivitet i prokurimit, por me pretendime të tij e atakon vetëm OE të rekomanduar, i cili edhe e ka ofertën më të lirë. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Ideal Shala B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: